

### Vështrim mbi tregjet

- Ecuria e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar 2022
- Tregu me pakicë i titujve të Qeverisë për vitin 2021
- Të dhënat e tregut të fondeve të investimeve për vitin 2021
- Ecuria e tregut të pensionit privat vullnetar për vitin 2021

### Zhvillime të tjera

- Përfundon konkursi studentor “Loja virtuale në bursë”
- AMF, trajnime me profesionistët në sigurime për ndryshimet ligjore e rregullatore

### Publikime Profesionale

- BIS Monedhat dixhitale dhe shpirti i parasë - Agustín Carstens
  - Global Risk Regulator - Rregulatorët vendosin kufizime mbi promovimet e kriptove
  - Risk Management - Bordi i Stabilitetit Financiar, FSB, po shqyrton hartimin e politikave ndaj kripto-aseteve në rritje
- Volumi 15, Nr. 1 - numër special mbi ESG (*Environment, Social, Governance*) në Institucionet Financiare

### Informacione Ndërkombëtare

- Bullgari
- Kroaci
- Mali i Zi
- Maqedoni e Veriut
- Rumani
- Turqi
- Tregjet e Evropës Qendrore dhe Lindore

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Ecuria e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar 2022

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për muajin janar 2022 kapën vlerën 1,422 milionë lekë, ose 5.16% më pak se në janar 2021. Gjatë muajit janar 2022, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 83,798 me një rritje prej 17.72% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.55% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 7.4%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 39.68% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 60.32% të totalit të tregut.


Gjatë muajit janar 2022, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 387 milionë lekë, ose 28.34% më pak se në periudhën janar 2021, ndikuar kryesisht nga pagesa e pjesës më të madhe të dëmshpërblimeve për tërmetet e fund vitit 2019, gjatë vitit të kaluar.

Ndërkohë dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për muajin janar 2022 kapën vlerën 297 milionë lekë, duke pësuar një ulje me rreth 1.93% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

### Struktura e tregut të sigurimeve, Janar 2022 (Në %)



Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për muajin janar 2022 kapën vlerën 297 milionë lekë, duke pësuar një ulje me rreth 1.93% krahasuar me muajin janar 2021.



## Tregu i Titujve të Qeverisë, për vitin 2021

Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë për vitin 2021, u dominua në masën 58.13% nga transaksione në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 41.87% nga transaksionet në instrumente afatgjatë (obligacione). Parë nga këndvështrimi i numrit të transaksioneve, 79.06% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të titujve të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të titujve të Qeverisë për vitin 2021, flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 50.60% dhe 33.92% kundrejt vëllimit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë, për vitin 2021 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.21% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

### Dy grupet e transaksioneve B dhe C


Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë vitit 2021, ka pasur një ulje prej 394 milionë lekë ose 13.68% krahasuar me vitin 2020. Numri i transaksioneve i llojit B është ulur në masën 22.32%.

Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë vitit 2021, ka pasur një rritje prej 6 milionë lekë ose 0.22%, ndërkohë pati gjithashtu rritje në numrin e transaksioneve në masën 7.44%, krahasuar me vitin 2020.

Në totalin e transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku, vihet re një ulje në vlerë absolute me rreth 388 milionë lekë, krahasuar me vitin 2020.

Tregu i Titujve të Qeverisë, viti 2021

(Në %)



Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë, për vitin 2021 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.21% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

## Ecuria e tregut të fondeve të Investimeve për vitin 2021


Në fund të vitit 2021, në tregun e fondeve të investimeve ushtruan aktivitetin e tyre njëmbëdhjetë fonde investimi. Fondi i investimeve “Raiffeisen Prestigj”, “Raiffeisen Invest Euro”, “Raiffeisen Vizion” dhe “Raiffeisen Mix” të administruara nga shoqëria “Raiffeisen Invest” sh.a., fondi i investimeve “Credins Premium” nën administrimin e shoqërisë administruese “Credins Invest” sh.a., fondi “WVP Top Invest” dhe fondi “WVP GLOBAL” administrohet nga shoqëria “WVP Fund Management Tirana sh.a.”, fondi i investimeve “Albsig Standard” nën administrimin e shoqërisë administruese “Albsig Invest” sh.a., fondi “ABI EIA”, “ABI FLEX EURO”, “ABI FLEX USD” administrohet nga shoqëria “ABI Invest” sh.a.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve në 31.12.2021, vlera neto e aseteve të fondeve, arriti rreth 77.69 miliardë lekë me një rritje prej 10,287 milionë lekë ose 15.26%, krahasuar me 31.12.2020.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare, të cilat përbëjnë 64.25% të aseteve të fondeve, me një rritje prej 8.15% krahasuar me 31.12.2020.

Numri i anëtarëve që kanë investuar në fondet e investimit më 31.12.2021 është 40,054 me një rritje prej 26.65% krahasuar me 31.12.2020.

### Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të investimeve më 30.09.2021 (Në %)



Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve në 31.12.2021, vlera neto e aseteve të fondeve, arriti rreth 77.69 miliardë lekë me një rritje prej 10,287 milionë lekë ose 15.26%, krahasuar me fundin e vitit 2020.


## Të dhënat e tregut të pensionit privat vullnetar për vitin 2021

Në fund të vitit 2021, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre katër fonde pensioni.


Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 31.12.2021 tregon një total asetesh neto prej 4,584.54 milionë lekë ose rreth 37.96 milionë euro dhe me një rritje prej 981.27 milionë lekë ose 27.23% krahasuar me 31.12.2020.

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, më 31.12.2021 rezultoi 33,571 anëtarë duke shënuar një rritje prej 8.22% krahasuar me 31.12.2020.

### Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensioneve vullnetare për vitin 2021 (Në %)



### Ndarja e tregut sipas vlerës neto të aseteve në fondet e pensioneve vullnetare, viti 2021 (Në %)



# ZHVILLIME TË TJERA

## Përfundon konkursi studentor “Loja virtuale në bursë”



15 shkurt 2022 – Takim përmbyllës *online* “Loja virtuale në bursë”

Në një takim *online*, më 15 shkurt, u përmbyll konkursi mes skuadrave studentore për “Lojën virtuale në bursë”. Në këtë konkurs të njohur ndërkombëtar si *Stock Market Learning Competition*, morën pjesë për herë të parë edhe 25 skuadra me studentë shqiptarë nga 15 universitete publike dhe private në vend. Konkursi u organizuar nga organizata gjermane “German Sparkassenstiftung Albania” dhe Shoqata Shqiptare e Tregtarëve të Titujve (ASTA) si edhe me mbështetjen e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Skuadrat e studentëve, përgjatë disa javëve të lojës virtuale në bursë, hynë në platformën virtuale të bursës, u pajisën me fonde virtuale, investuan në tituj financiarë sipas çmimeve reale të tregtimit në tregjet financiare ndërkombëtare. Ata krijuan portofolet e tyre të investimit, hartuan strategji të ndryshme investimesh në treg, sikurse do të kishin vepruar në rolin e një këshilltari investimesh për klientë të ndryshëm.

Gjatë kësaj periudhe disa javore të lojës virtuale të studentëve në bursë, tregjet ndërkombëtare të kapitalit u përballën me tre ngjarje të rëndësishme që i influencuan ndjeshëm ato, siç ishin shfaqja e variantit “Omicron” të Covid 19, më pas ajo që u quajt kriza energjetike e fillim vitit 2022 dhe pas saj luhatjet në rritje të inflacionit. Këto influencuan performancën e bursave ndërkombëtare dhe për rrjedhojë u ndjenë edhe në performancën virtuale në bursë të skuadrave studentore.

Në konkursin ndërkombëtar *Stock Market Learning Competition*, morën pjesë për herë të parë edhe 25 skuadra me studentë shqiptarë nga 15 universitete publike dhe private në vend..



... vijon

Duke vlerësuar disa tregues si për performancën në tregje, qëndrueshmërinë në transaksionet financiare, një juri e pavarur ndërkombëtare vlerësoi portfolet e investimeve për secilën skuadër, dhe vlerësoi me çmimet përkatëse sipas këtyre dy kategorive. Juria vlerësoi si strategjinë e investimit ashtu edhe transaksionet e realizuara kundrejt performancës reale të tregjeve. Universitetet si Zonja e Këshillit të Mirë, Universiteti Evropian i Tiranës, Universiteti Luarasi, Universiteti i NY në Tiranë, ishin midis ekipeve me rezultatet fituese në lojën virtuale të bursës.

Duke i përshëndetur studentët pjesëmarrës në këtë aktivitet znj. Mimoza Kaçi, Nëndrejtorë Ekzekutive e AMF-së u shpreh se pjesëmarrja e studentëve në këtë konkurs ishte një përvojë e mirë për ta, në njohjen e instrumenteve në tregjet e kapitaleve dhe një kolonë e rëndësishme në karrierën e tyre të mëtejshme në fushën financiare. Znj. Kaçi theksoi se Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare do të ofrojë për studentët e skuadrave fituese mundësinë e zhvillimit të praktikave mësimore pranë AMF-së, si një mundësi për t'u njohur nga afër me aktivitetin rregullator dhe mbikëqyrës të institucionit.

Drejtuesi i Shoqatës Shqiptare të Tregtarëve të Titujve (ASTA), z. Blodin Çuçi u shpreh entuziast për ecurinë e skuadrave në këtë lojë virtuale dhe vlerësoi studentët për volumin e transaksioneve të kryera dhe strategjitë e ndjekura.

Drejtues të organizatës “German Sparkassenstiftung Albania” theksuan se në muajin tetor 2022 do të zhvillohet sërish loja virtuale e bursës dhe ftuan studentët dhe fakultetet ekonomike të universiteteve në vend të marrin pjesë me skuadra të tjera për t'i shërbyer kështu edukimit financiar të të rinjve.

Në muajin tetor 2022 do të zhvillohet sërish loja virtuale e bursës.

Fondacioni gjerman Sparkassenstiftung Albania fton studentët dhe fakultetet ekonomike të universiteteve në vend të marrin pjesë me skuadra të tjera për t'i shërbyer kështu edukimit financiar të të rinjve.

## AMF, trajnime me profesionistët në sigurime për ndryshimet ligjore dhe rregullatore




Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në funksion të rritjes së nivelit të shërbimeve ndaj konsumatorit, zgjerimit të njohurive të profesionistëve të fushës, si edhe rritjes së edukimit financiar për tregjet nën mbikëqyrje, zhvilloi në datat 15-16 shkurt disa sesione trajnimi me vlerësuesit e dëmeve në sigurime.

Tematika kryesore e programit të trajnimit ishte përditësimi i profesionistëve të fushës me ndryshimet e fundit ligjore dhe rregullatore, pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" dhe Rregullores "Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit". Programi i trajnimit përfshinte gjithashtu shembuj praktikë sa i përket procedurës së vlerësimit dhe trajtimit të dëmit në sigurimin e detyrueshëm motorik, me qëllim që profesionistët e fushës të aplikojnë parimet më të mira të vlerësimit dhe llogaritjes së dëmit.

Vlerësuesit e dëmeve në sigurime përdorën gjatë trajnimit aplikacionin e zhvilluar nga Autoriteti për llogaritjen e dëmeve ndaj personit, në rastet e aksidenteve nga mjetet motorike në sektorin e transportit. Aplikacioni, i cili bazohet në disa supozime, me vlera orientuese, u vjen në ndihmë profesionistëve të fushës në përlllogaritjen e vlerës së dëmshpërblimit në rastet e dëmit ndaj personit, me pasojë paaftësinë e përherëshme për punë ose me pasojë vdekjen.

Pjesëmarrësit në trajnim u njohën gjithashtu me kompetencat, kualifikimet dhe detyrimet që burojnë nga Ligji 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" për vlerësuesit e dëmeve në sigurime, si edhe u informuan mbi procedurat dhe afatet e trajtimit të ankesave, nga ana e shoqërive të sigurimit, si edhe nga Autoriteti.





## Monedhat dixhitale dhe shpirti i parasë



<https://www.bis.org/speeches/sp20118.htm>

*Fjala e Agustín Carstens, Menaxher i Përgjithshëm i BIS, gjatë konferencës së Institutit për Ligjin dhe Financën (ILF) të Universitetit Goethe me temë "Të dhënat, dixhitalizimi, financat e reja dhe monedhat dixhitale të Bankës Qendrore: E ardhmja e Bankës dhe Parasë", 18 janar 2022.*

*Çfarë e mban sistemin monetar të bashkuar në thelbin e tij? Në një fjalim në konferencën e Institutit të Drejtësisë dhe Financës për të Ardhmen e Sistemit Financiar pranë Universitetit Goethe, z. Agustín Carstens merr frymëzim nga gjigandi letrar gjerman Goethe për të reflektuar mbi shpirtin e parasë në epokën dixhitale.*

*BIS e publikon të plotë materialin edhe me video – Më poshtë janë vetëm disa nga pikat kryesore të fjalës së mbajtur.*

*(Marrë me shkurtime)*

...

Sot do të marr frymëzim nga emri i institucionit tuaj. I madhi Johann Wolfgang von Goethe ishte një kozmopolit, që kishte udhëtuar shumë dhe pra një universalist i vërtetë. Ai ishte një poet dhe romancier, një dramaturg dhe regjisor teatri, një shkencëtar dhe burrë shteti.

Për çudinë tonë dhe në mënyrë të jashtëzakonshme, me punën e tij ai parashikoi disa çështje kryesore ekonomike të kohës sonë, duke përfshirë pavarësinë e bankës qendrore.

Vepra e Gëtes përballlet me pyetje themelore. Në kryeveprën e tij, Faust, ai trajton "Gretchenfrage" - një term që është bërë sinonim i një çështjeje themelore të jetës.

Për bankierët qendrorë, "Gretchenfrage" ka qenë gjithmonë: Cili është shpirti i parasë?

## Monedhat dixhitale dhe shpirti i parasë

...

Sot, teknologët, novatorët dhe futuristët po ofrojnë përgjigje të reja për këtë pyetje. Disa thonë se në të ardhmen, paratë dhe financat do të sigurohen nga vetëm disa korporata të mëdha teknologjike. Të tjerë ëndërrojnë për një sistem të decentralizuar në të cilin zinxhirët dhe algoritmet zëvendësojnë njerëzit dhe institucionet. Dhe ndoshta, e gjithë kjo do të ndodhë në Metaverse.

Mesazhi im kryesor sot është i thjeshtë: Shpirti i parasë nuk i përket as një teknologjie të madhe dhe as ndonjë libri anonimë. Shpirti i parasë është besimi. Pra, shtrohet pyetja: Cili institucion është më i miri për të gjeneruar besim? Unë do të argumentoj se bankat qendrore kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë institucionet më të vendosura për të ofruar besim në epokën dixhitale. Kjo është gjithashtu mënyra më e mirë për të siguruar një sistem financiar efikas dhe gjithëpërfshirës në dobi të të gjithëve.

...

Më poshtë shtjellohen disa nga piketat themelore:

- Bazat institucionale të parasë;
- Stablecoins të teknologjisë së madhe;
- Premtimi i papërcaktuar i decentralizimit;
- Një sistem i hapur dhe global si një e mirë publike.

...

Konkluzioni

E ardhmja e parave na takon ta formësojmë. Ndërsa bankat qendrore ndajnë eksitim rreth inovacionit dixhital, ne jemi të vetëdijshëm për pasojat e mundshme të disa prej mishërimeve të tij.

Dizajni i parasë ka pasoja që shqetësojnë të gjithë shoqërinë: integritetin dhe stabilitetin e parave dhe pagesave, përqendrimin e tregut, të drejtat e konsumatorit dhe efikasitetin. Prandaj, bankierët qendrorë duhet të punojnë me autoritetet e tjera publike dhe palët e interesuara private për ta bërë realitet vizionin që kam përshkruar.

Le të inovojmë në një mënyrë të shëndetshme e të qëndrueshme, duke shfrytëzuar përfitimet e teknologjisë dixhitale në një mënyrë që është në përputhje me vlerat tona të përbashkëta. Në veçanti, le të sigurojmë që sistemi ynë financiar të ndërtohet mbi qeverisjen ekzistuese të parasë, t'i shërbejë interesit publik dhe të punojë në bashkëpunim me sektorin privat. Pra, më lejoni të kthehem atje ku kam filluar, te Gëte. Përgjigja ndaj "Gretchenfrage" nuk ka ndryshuar: Bankat qendrore dhe autoritetet publike janë ende elementi që mban të bashkuar sistemin monetar dhe atë financiar.

Shërbimet dhe inovacioni i sektorit privat janë thelbësore dhe duhet të lulëzojnë mbi këtë bazë. Por besimi nuk mund të kontraktohet kurrë dhe as të automatizohet.



<https://www.bis.org/speeches/sp20118.htm>



Subjects / Financial Markets

## Regulators clean-up crypto promotions

Justin Pugsley | January 27, 2022



UK and Spanish regulators are among those tightening the noose around firms promoting high risk investments, like crypto assets, to the general public.

- Rregulatorët vendosin kufizime mbi promovimet e kriptove**  
*(Regulators clean-up crypto promotions)*

**Justin Pugsley**

Rregullatorët e Mbretërisë së Bashkuar dhe Spanjës janë ndër ata që po e ngushtojnë lakun rreth firmave që promovojnë investime me rrezik të lartë për publikun e gjerë, siç janë kriptu-asetet.

- Bordi i Stabilitetit Financiar, FSB, po shqyrton hartimin e politikave ndaj kriptu-aseteve në rritje**  
*(FSB ponders policy responses to proliferating crypto-assets)*

**Justin Pugsley**

Rreziqet që lidhen me kriptu-asetet dhe financat e decentralizuara (DeFi) mund të kërcënojnë së shpejti sistemin financiar, thotë Bordi i Stabilitetit Financiar (FSB), duke nxitur të studiohet e të hartohen politikat e mundshme për t'ju përgjigjur zhvillimeve të reja.

## Volume 15 (2022)

SUBSCRIBE NOW &gt;

Each volume of *Journal of Risk Management in Financial Institutions* consists of four 100-page issues, published both in print and online. Articles scheduled for Volume 15 are available to view on the [Forthcoming content](#) page.

The papers and case studies confirmed for Volume 15 are listed below:

[Volume 15 Number 1](#)

Special Issue: *Advances in ESG: Integration, risk management and thematic investing*


Guest Editors: *Dr. Luis Seco, CEO, Sigma Analysis & Management, Professor of Mathematical Finance, University of Toronto and Alik Sokolov, CEO, SR.ai, PhD Candidate, Mathematical Finance, University of Toronto*



## Revista “Menaxhimi i Riskut në Institucionet Financiare” (*Journal of Risk Management in Financial Institutions*) Vëllimi 15, (2022) Numri 1 [www.henrystewartpublications.com/jrm/v15](http://www.henrystewartpublications.com/jrm/v15)

Ky numër përmban ndër të tjera edhe artikujt e mëposhtëm:

- Editorial - “Progresi për ESG (*Environment, Social, Governanace*): Integrimi, menaxhimi i riskut dhe investimi tematik”, - Dr. Luis Seco, CEO, Sigma Analysis & Management, Profesor i Financës Matematikore, Universiteti i Torontos dhe Alik Sokolov, CEO, SR.ai, Ph.D kandidat, Financa matematike, Universiteti i Torontos.
- Opinion - “A po ndikon investimi i ESG në kalimin drejt një ekonomie të qëndrueshme apo në keqshpërndarjet më të mëdha të kapitalit dhe një mundësi e humbur?” – Dr. Madelyn Antoncic, Anëtare e Bordit të Drejtorëve ACWA POWER, Arabia Saudite; S&P Global Ratings & FinTech Acquisition Corp VI, SHBA.
- “Si mund të zbatohet testimi i stresit për rrezikun klimatik?” - Greg Hopper, Drejtor Menaxhues, Goldman Sachs
- “Përcaktimi sasior i pasigurisë së rrezikut klimatik në mjediset konkurruese të biznesit.” - Jorge R. Sobehart, Drejtor Menaxhues dhe Drejtor i Analitikës së Riskut të Kredisë dhe Obligorit, Citi
- “Menaxhimi i rreziqeve të ndryshimeve klimatike: Roli i qeverisjes dhe analizës së skenarit.” - Laurent Clerc, Drejtor për Kërkimin dhe Analizën e Riskut, Autorité de Contrôle Prudentiel et de Resolution.
- “Si të përmirësohet profili ESG i portofoleve duke mbajtur një kthim të ngjashëm të rregulluar nga rreziku.” - Antoine Kopp, Dominic Barbe, Rémy Cottet dhe Gabriele Susinno, Pictet Asset Management
- “ESG si input për një shtresë mbrojtëse të qëndrueshmërisë së kapitalit.” - Martin Neisen, Partner, Benjamin Bruhn, Menaxher dhe Dieter Lienland, Drejtor, PricewaterhouseCoopers
- “Rreziku i ndryshimit të klimës: Kufiri tjetër në menaxhimin e rrezikut bankar.” - Hanna Sarraf, Zyrtare Shefe e Riskut e Grupit, Bankmed Group
- “Të bëhesh pjesë e tavolinës së diskutimeve për ESG.” - Jonny Frank, Partner, Jim Barolak, Partner dhe Germari Pieterse, Drejtor Menaxhues, StoneTurn



## Volume 15 (2022)

[SUBSCRIBE NOW >](#)


Each volume of *Journal of Risk Management in Financial Institutions* consists of four 100-page issues, published both in print and online. Articles scheduled for Volume 15 are available to view on the [Forthcoming content](#) page.

The papers and case studies confirmed for Volume 15 are listed below:

### Volume 15 Number 1

#### Special Issue: Advances in ESG: Integration, risk management and thematic investing

Guest Editors: Dr. Luis Seco, CEO, Sigma Analysis & Management, Professor of Mathematical Finance, University of Toronto and Alik Sokolov, CEO, SR.ai, PhD Candidate, Mathematical Finance, University of Toronto



Revista "Menaxhimi i Riskut në Institucionet Financiare"  
(*Journal of Risk Management in Financial Institutions*)  
Vëllimi 15, (2022) Numri 1

[www.henrystewartpublications.com/jrm/v15](http://www.henrystewartpublications.com/jrm/v15)

"Menaxhimi i rreziqeve të ndryshimeve klimatike: Roli i qeverisjes dhe analizës së skenarit." - Laurent Clerc, Drejtor për Kërkimin dhe Analizën e Riskut pranë Autoritetit të Kontrollit të Kujdesshëm dhe Rezolucionit.

### Abstrakt:

Ndryshimet klimatike dhe rreziqet mjedisore, siç ilustron nga ngjarjet ekstreme të motit dhe humbjet e biodiversitetit, përbëjnë një kërcënim themelor për njerëzimin.

Thirrjet për veprim janë intensifikuar dhe presionet në sektorin financiar janë rritur ndjeshëm. Si rezultat, pasqyrimi i treguesve mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes (ESG) dhe vlerësimi i rrezikut janë përmirësuar.

Në këtë kontekst, ky dokument thekson rolin vendimtar të qeverisjes dhe analizës së skenarëve në rritjen e efektivitetit të menaxhimit të rrezikut mjedisor dhe ndryshimeve klimatike. Në document janë dhënë shembuj konkretë, duke u mbështetur në disa rezultate të fazes pilot të projektit të klimës nga Autoriteti Frances i Mbikëqyrjes së Kujdesshme, ACPR (*French Prudential Supervision and Resolution Authority*) për të ilustruar rëndësinë e analizës së skenarëve.

Fjalët kyçe: ESG, ndryshimi i klimës, menaxhimi i rrezikut, qeverisja, testimi i stresit, analiza e skenarit

# INFORMACIONE NDËRKOMBËTARE

## BULLGARI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas informacionit të publikuar në faqen online të Shoqatës së Siguruesve Bullgarë, ABZ, kryetar i saj Konstantin Veleu ka deklaruar se "... një rritje graduale e çmimeve të MTPL është vërejtur që nga mesi i vitit 2021 - me rreth 10% në krahasim me fillimin e vitit të kaluar". Rritja e çmimeve për sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta për mjetet motorike mesatarisht me rreth 10% është raportuar në krahasim me çmimet e janarit të vitit të 2020. Pas një rënijeje në vitin 2020, një rritje graduale filloi nga mesi i vitit 2021. Konstantin Veleu shpjegoi gjithashtu se rritja është e ndryshme duke marrë parasysh kriteret si kapaciteti i automjetit, mosha e shoferit dhe rajoni. "Ky sigurim duhet të jetë i disponueshëm për konsumatorët. Jemi plotësisht të vetëdijshëm që është i detyrueshëm, por duhet të kemi parasysh edhe se luan një rol social duke garantuar të drejtën e dëmshpërblimit për viktimat e pafajshme të aksidenteve rrugore", theksoi Konstantin Veleu.

Sipas referimit të Shoqatës së Siguruesve Bullgarë, një parashikim i saktë i tendencës së çmimeve nuk mund të bëhet, por ka të ngjarë që në vitin 2022 të ketë një lëvizje të qetë në rritje për shkak të disa faktorëve, kryesori është dëmi. Vlen të theksohet se rritja e çmimeve të pjesëve të këmbimit, shërbimeve të riparimit të makinave dhe të tjera, aktualisht nuk është reflektuar në çmimet e MTPL-së. Gjithashtu kreu i shoqatës ABZ shprehu shpresën se këtë vit do të miratohet rregullorja për *Bonus-Malus*, procesi i cili u shty për shkak të pandemisë në vazhdim.

## KROACI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Të dhënat paraprake të tremujorit të katërt 2021 të publikuara nga Byroja Kroate e Sigurimeve tregojnë se vëllim i primeve të shkruara bruto të 15 siguruesve kroatë u rrit 11.86% gjatë viti 2021, duke arritur në 11.71 miliardë HRK (monedha vendase) ose rreth 1.55 miliardë euro. Nga ana tjetër vëllimi i dëmeve të paguara bruto gjatë vitit 2021 u rrit në 7.29 miliardë HRK, nga 6.53 miliardë HRK që ishte një vit më parë.

Rritjen më të madhe gjatë vitit 2021 e patën primet shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës me rritje 12.68%, duke arritur në rreth 8.81 miliardë HRK. Ndërsa sigurimi i Jetës u rrit me 9.44% duke arritur në 2.89 miliardë HRK.

## MALI I ZI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave paraprake të publikuara në faqen e internetit të *Insurance Supervision Agency, ISA*, tregu i sigurimeve i Malit të Zi raportoi një rritje vjetore të primeve të shkruara bruto prej 5.5% gjatë vitit 2021, duke arritur në 99 milionë euro.

Segmenti i sigurimit të Jo-Jetës zinte rreth 80% të shifrës totale të primeve të shkruara bruto, duke arritur në 79 milionë euro, ndërsa sektori i sigurimeve të Jetës përbënte pjesën e mbetur prej 20%, ose rreth 20 milionë euro. Në vlera absolute tregu i sigurimeve i Malit të Zi u rrit me 5 milionë euro, nga të cilat 2 milionë euro u regjistruan vetëm në sigurimin motorik MTPL.

## MAQEDONIA E VERIUT

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave paraprake të publikuara nga ISA, Autoriteti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë së Veriut, në fund të vitit 2021, tregu maqedonas i sigurimeve arriti në 11.62 miliardë dinarë, ose rreth 188.7 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 15.5% krahasuar me vitin e kaluar.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto nga sigurimet e Jo-Jetës u rrit me 15.7% krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në 9.6 miliardë dinarë. Sigurimi i Jo-Jetës zë rreth 82.8% të primeve totale. Ndërsa segmenti i sigurimit të Jetës raportoi një vëllim primesh prej 2 miliardë dinarë, ose 15% më shumë krahasuar me vitin e kaluar.

Edhe dëmet e paguara bruto u rritën mbi 16%, duke arritur në 4.66 miliardë dinarë ose 75.7 milionë euro. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara, prej 4 miliardë dinarë lidhej me kontrata të sigurimit të Jo-Jetës dhe 0.6 miliardë dinarë ishin dëme në sigurimin e Jetës.

## RUMANI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave paraprake publikuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Rumanisë (ASF), në vitin 2021, tregu rumun i sigurimeve pati një rritje prej 24% të primeve të shkruara bruto, duke arritur përafërsisht vlerën e 2.86 miliardë euro.

Linjat e sigurimit të Jo-Jetës përbënin pjesën më të madhe të tregut me rreth 74% të totalit të primeve. Vëllimi i primeve të shkruara bruto të Jo-Jetës arriti në rreth 2.32 miliardë euro, me rritje 25.4% në terma vjetorë. Linjat e sigurimit motorik përbënin 74% të primeve të shkruara bruto në sigurimet e Jo-Jetës (51% MTPL dhe 23% Sigurimi Kasko), ndërsa të gjitha linjat e tjera të sigurimit jo-motorike përbënin së bashku rreth një të katërtën (26%) të portofolit të Jo-Jetës.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 17.6% gjatë vitit 2021 krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 0.52 miliardë euro.

Duke folur në një tubim profesional në Bukuresht, nënkryetari i ASF-së i ngarkuar me mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve, Z. Cristian Rosu theksoi: “Sfida më e rëndësishme e vitit 2021 për tregun vendor të sigurimeve ishte përthithja e falimentimit të “CITY Insurance” dhe jam i lumtur të them se tregu ka reaguar me shumë racionalitet, i gjithë procesi ka shkuar mirë deri tani dhe nuk presim goditje të mëtejshme”. Ai shtoi gjithashtu se diversifikimi i portofolit të tregut mbetet një prioritet kryesor, pasi dominimi aktual i linjave të sigurimeve motorike e bën të vështirë menaxhimin e rreziqeve dhe ofrimin e çmimeve të përballueshme të sigurimit duke ruajtur ende stabilitetin financiar të tregut. Analistët e tregut të sigurimeve besojnë se sigurimi i banesave, sigurimi shëndetësor, apo edhe sigurimi i garancisë mund të jenë nxitësit e rritjes së tregut gjatë vitit 2022.

## TURQI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave paraprake të publikuara nga Shoqata e Sigurimeve të Turqisë, TSB, vëllimi total i primeve të gjeneruar në tregun turk të sigurimeve u rrit me 27.53% e shprehur në monedhën vendase, duke arritur në 105.30 miliardë TRY në vitin 2021.

Për shkak të zhvlerësimit të lirës turke ndaj euros, tregu vendas i sigurimeve, i shprehur në monedhën evropiane u ul me rreth 23% në terma vjetorë ose me rreth 2 miliardë euro kundrejt vitit 2020 ose me 3.4 miliardë euro më pak kundrejt vitit 2019.

Duke analizuar shifrat e tregut turk të sigurimeve të shprehur në monedhën vendase, primet e sigurimit të Jo-Jetës për vitin 2021 u rritën me 28.52% dhe në shifra reale arritën në 87.58 miliardë TRY. Primet e sigurimit të Jetës u rritën me 22.83% në vit, duke arritur në 17.72 miliardë TRY.

Në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës në vitin 2021, dy degët me vëllimin më të lartë të primeve ishin MTPL-ja e detyrueshme, e cila u rrit me 13.77% krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 23.30 miliardë TRY si edhe sigurimi Kasko me 14.29 miliardë TRY duke shënuar rritje prej 33.10% në vit.



## Tregjet e Evropës Qendrore dhe Lindore

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave tremujore të tregut të sigurimeve të përpunuar nga Xprimm.com, vëllimi i primeve të shkruara bruto të raportuara nga 17 vende të Evropës Qendrore dhe Lindore arriti në 30.35 miliardë euro në fund të shtatorit 2021, duke shënuar rreth 2.4 miliardë euro më shumë krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2020 ose me një ritëm rritje vjetore prej 8.56% në vit. Nga ana tjetër, dëmet e paguara nga siguruesit e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore u rritën me gati 1 miliardë euro, duke arritur në 17 miliardë euro në fund të tremujorit të tretë 2021.

Tre shtete të Evropës Jug Lindore siguruan një vëllim të primeve të shkruara bruto respektivisht Qipro - 701 milionë euro, Greqia – 3.16 miliardë euro, Turqia - 6,85 miliardë euro. Duke bashkuar këto prime, rezulton se për 20 vendet e marra së bashku, gjatë 9-mujorit 2021 vëllimi i primeve të shkruara bruto kalon mbi 41 miliardë euro, krahasuar me rreth 38 miliardë euro që ishte në fund të shtatorit 2020.

Shifrat, sipas Xprimm, tregojnë se vetëm katër tregje të Evropës Qendrore dhe Lindore kishin vëllimin më të madh të primeve:

Polonia	10.98 miliardë euro
Republika Çeke	5.28 miliardë euro
Hungaria	2.77 miliardë euro
Sllovenia	2.03 miliardë euro.

Tregjet më të vogla ishin Kosova - 88.31 milionë euro dhe Mali i Zi - 74.43 milionë euro.

Sipas linjave të biznesit, primet e shkruara bruto të sigurimit të Jetës u rritën me 7.7% në vit duke arritur në 9.26 miliardë euro për të gjitha vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Vlen të përmendet se ndër tregjet e sigurimeve të Evropës Qendrore dhe Lindore që raportuan përqindjet më të mëdha të sigurimit të Jetës në totalin e primeve të shkruara bruto ishin Hungaria, ku sigurimet e Jetës zinin 44.45% të totalit të primeve, Republika Sllovaqe me 41.73% dhe Polonia me 32.53% të totalit të primeve.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës arritën në 21.09 miliardë euro ose rreth 9% më shumë në vit. Nga ky vëllim i primeve, 4.23 miliardë euro ishin sigurim pasurie, 6.73 miliardë euro ishin prime të linjës së MTPL-së dhe 4.35 miliardë euro – Sigurimi Kasko.



---

---

## AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)